

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Instituti për Studime të Avancuara GAP, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, me bazë juridike kërkesë për qasje në dokumente publike, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.750/2013, të datës 12.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M


Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.750/2013, i datës 12.12.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.750/2013, të datës 12.12.2017, është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit Instituti për Studime të Avancuara GAP. Ndërsa detyrohet e paditura Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, që brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ti lejoj paditësit Instituti për Studime të Avancuara GAP, me seli në Prishtinë, të ketë qasje në dokumente publike që lidhen me procesin e privatizimit të KEDS, dhe ofrimit të projektit "Kosova e Re"

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, përmes përfaqësueses së autorizuar Ministria e Drejtësisë - Avokatura Shtetërore, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimi A.nr.750/2013, i datës 12.12.2017, i goditur me këtë ankesë të prishet dhe çështja të kthehet në riprocedurë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:



Ankesa është e pa bazuar.


Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi për konflikt administrativ, kundër të paditurës me datën 03.06.2013, me të cilin ka kërkuar nga gjykata vërtetimin e shkeljes së Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, se i është mohuar e drejta për qasje në dokumente publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Njësinë Implementuese të Projektit KEDS (Rrjeti i Distribucionit dhe Shpërndarjes së KEK), që është segment i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, duke kërkuar qasje në planin afarist të KEDS, të datës 25.03.2013.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar me të cilën është kërkuar lejimi në qasje në dokumente publike. Me arsyetim se e paditura ka refuzuar të ofrojë dokumentin në formën e kërkuar, duke pretenduar se disa shtojca të dokumentit të kërkuar, janë ende në formë të draftit dhe nuk janë të finalizuara. Andaj, gjykata e shkallës së parë vlerëson se ky pretendim është i pa bazuar, për faktin se dokumentet e tilla të institucioneve publike duhet të jenë të hapura për qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe nga ky aspekt ata kanë drejtpërsëdrejti interes të arsyeshëm të informohen lidhur me këtë përmbajtje.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, përgjegjës në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë iu ka referuar Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 41, Ligjit Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, përkatësisht nenit 2 par. 1, 2, nenit 11 par.1 dhe nenit 12, si dhe nenit 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Sa i përket pretendimeve ankimore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore në ankesë për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se konsideron se nuk janë vlerësuar në mënyrë të duhur provat, sikurse kërkesa e datës 20.03.2013 e GAP (dhe jo e datës 25.03.2013, ashtu siç potencohet në aktgjykim), ka të bëjë me listën e asetëve të cilat do të transferohen (shiten konsorciumit Calik & Limak), dhe jo qasja në planin afarist të KEDS, siç është specifikuar në aktgjykim. Pastaj se e paditura iu është përgjigjur pozitivisht kërkesës së paditësit për qasje në dokumente publike, dhe



dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”. Andaj për këto arsye gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se dokumentet e tilla të institucioneve publike duhet të jenë të hapura për qytetarët, ngase ata kanë drejtpërsëdrejti interes të arsyeshëm të informohen lidhur me këtë përmbajtje.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve tjera ankimore, se asnjë nga kërkesat e paditësit drejtuar të paditurës në muajin Mars dhe Prill të vitit 2013, nuk kanë qenë për ofertimin e projektit “Kosova e Re”, dhe se aktgjykimi duhet të drejtohet KEK-ut, si institucion që bie në fushëveprimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike për kërkesat drejtuar KEK-ut, që kanë të bëjnë me listën e aseteve, dhe se nga kjo situatë aktgjykimi është i pa bazuar, dhe si i tillë është kontradiktor, i pa kuptueshëm në lidhje me dispozitivin dhe arsyetimin e dhënë. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, për faktin se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.72/2018, me datë 13.12.2018

AKTËSINË E KOPJES E VËRTETUAR
DHE HEQËSI I SHKRIMORES SË GJYKATËS
TAČNOST KOPIJE POTVRDUJE
RUKOVOĐIOČ SUDSKE PISARNICE

Lj. B.



Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi